




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
ASSEMBLY OF KOSOVO
Kosovo
No. Prot. 06/705/00-432
Prot. No. 13.02.2018
PRISTINA - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly


PËR / ZA / TO	<i>Uran Ismaili – Ministër i Shëndetësisë</i>	DATE DATUM DATE	13.02.2018
		Reference	
NGA / OD / FROM	<i>Haxhi Avdyli – Deputet i LDK-së</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Sistemi informimit shëndetësor.

Pyetja parlamentare: Edhe pse për shumë vite me radhë janë iniciuar projekte për instalimin e Sistemit informativ shëndetësor në institucionet shëndetësore. Janë bërë hapa të nevojshëm në pilot projekte në Prishtinë dhe Prizren por ska arrit deri tani në funksionalizimin e saj të plote edhe në këto komuna dhe në tërë sektorin shëndetësor në Kosove?

Duke e ditur që pa fillimin e sistemit të informimit shëndetësor nuk do mund të themelojmë fondin e qëndrueshëm, të sigurimeve shëndetësorë, pyetja ime ka të bëjë sa keni mundur të skanonin dhe të planifikoni fillimin e funksionalizimin e sistemit të informimit shëndetësor, sa keni staf, sa keni bërë për trajnimin e personelit shëndetësor, me cilat programe kompjuterike dhe sa keni arrit me shtri rrjetin nëpër institucione shëndetësore?



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

PER/ZA/TO	<i>Uran Ismaili – Ministër i Shëndetësisë</i>	DATE DATUM DATE	14.02.2018
		Reference	
NGA/OD/FROM	<i>Haxhi Avdyli – Deputet i LDK-së</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	Pyetje Parlamentare		

Në bazë të Rregullës 45 pika (2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëj pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës së Kuvendit të Kosovës.

Çështja: Pagat për punëtorë shëndetësor .

Pyetja parlamentare: Profesionistet shëndetësor edhe përkundër shkollimit dhe përgjegjësisë vazhdojnë të paguhet shume ulet. Para një kohe për shkak edhe veprimeve te pamenduara te Kryeministrit me rritjen e pagave për qeveritar është shkaktuar tension social gjë qe shume kirurge janë futur ne greve.

Pyetja :çka është bere për harmonizimin e pagave ne sektorin e shëndetësisë dhe si planifikoni te bëni kategorizimin e pagave ne këtë sektor



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

06/808/Dc-488
01.03.2018
PRISTINA

PËR/ZA/TO	<i>Ministrin e Shëndetësisë z.Uran Ismaili</i>	DATE DATUM DATE	01.03.2018
NGA/OD/FROM	<i>Deputetja Ganimete Musliu</i>		
SUBJEKTI PREDMET SUBJECT	<i>Pyetje për përgjigje me gojë</i>		

Në bazë të nenit 45 pika(2) e Rregullores së Punës së Kuvendit të Kosovës, bëjë pyetje për përgjigje me gojë në seancën e radhës të Kuvendit të Kosovës.

Çështja:

Në fillim të shkurtit ka filluar shërbimi 24 orësh në kardiologjin invasive.

PYETJE :


I nderuari Ministër:

A mund të na informoni rreth këtij shërbimi si po ecën dhe sa janë të kënaqur qytetarët me këtë shërbim dhe a janë mjaft të informuar për këtë shërbim duke pas parasysh se jo gjithëherë informimi i drejt arrinë në adresën e duhur dhe jo rrallë qytetarët bijnë pre e propagandës dhe manipulimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

06/847/D0-511
09.03.2018
PRISTINA - PRISTINA

Za :	Ministarstvo poljoprivrede, sumarstva i ruralnog razvoja – g.Nenad Rikalo
Od :	Duda Balje, Poslanica u Skupštini Kosova 
Datum :	09.03.2018
Predmet :	Parlamentarno pitanje (usmeni odgovor)

U skladu sa članom 45. Poslovnika o radu Skupštine Kosova, postavljam parlamentarno pitanje za usmeni odgovor na narednoj sednici Skupštine Kosova :

Obrazloženje :

Zemlja koja se daje na zakup (korišćenje) od strane Agencije za šumarstvo koja je utrina sela i koja se najčešće uzima od strane ljudi koji nisu iz istog sela pa ni opštine zbog nedovoljne informisanosti meštana direktno utiče na smanjivanje mogućnosti bavljenja stočarstvom.

Pitanje :

Da li postoji mogućnost pri davanju utrinskog zemljišta na korišćenje da se prvo konsultuje (obavesti) lokalno stanovništvo i da se njima da prednost (ukoliko su zainteresovani) u odnosu na druge stranke?

S' poštovanjem



REPUBLIC OF KOSOVO
KOSOVA
PRISTINA
06/847/10-511
09.03.2018
PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Për :	Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Nga :	Duda Balje, deputete e Kuvendit të Republikës së Kosovës
Datë :	9.3.2018
Lënda :	Pyetje parlamentare (përgjigje me gojë)

Duda Balje

Në pajtim me nenin 45 të Rregullores së Kuvendit të Kosovës, parashtroj pyetje parlamentare për përgjigje me gojë në mbledhjen e radhës së Kuvendit të Republikës së Kosovës:

A r s y e t i m:

Toka e cila jepet me qira (në shfrytëzim) nga ana e Agjencisë për Pylltari, e cila është djerrinë (kullosë) e fshatit dhe e cila, në të shumtën e herave, merret nga njerëzit, të cilët nuk janë nga i njëjti fshat e as nga komuna, për shkak të informimit të pamjaftuar të banorëve, drejtëpërdrejt ndikon në zvogëlimin e mundësive për ushtrimin e blegtorisë.

Pyetja :

A ekziston mundësia që, para dhënies së tokës djerrinë në shfrytëzim, së pari të konsultohet (informohet) popullata lokale dhe atyre t'u jepet përparësi (nëse janë të interesuar), në raport me palët tjera.

Me respekt,